

KËRKESË
Nr.246/2, datë 30.1.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Rrëshen”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga grupi i punës ngritur në këtë qëllim, vlerësim i cili është miratuar më pas nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listë emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre , të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 857 712 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë.

**LISTA E OBJEKTEVE NË PRONËSI PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT “MILOT-RRËSHEN”**

Nr.	Lloji i objektit	Emri i pronarit	Segmenti	Vlera lekë
1	Shtëpi banimi	Fran Mark Karagjozi	Milot-Rrëshen	3499765
2	Mur guri	Lek Bitraj	Milot-Rrëshen	43063
3	Mur rrethues	Zef Llesh Fusha	Milot-Rrëshen	514319
4	Klaçeto	Arben Bitri	Milot-Rrëshen	800565
		Totali		4857712